

RESTAURIMI I KISHËS SË SHËN E PREMTES NË FSHATIN ÇETË, KAVAJË



Projekti u hartua dhe u mbikëqyr nga Bërthama e Trashëgimisë Kulturore pranë Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë.

Projekti u miratua nga K.K.R. pranë Institutit të Monumenteve të Kulturës (I.M.K.)

Investitor: Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë.

Fondi i akorduar nga Kryepiskopi Anastas për këto ndërhyrje është 4,250,000 lekë.

Punimet u realizuan gjatë vitit 2011.

Pak historik

Për rindërtimin e kishës kemi të dhëna të sakta, por për ndërtimin fillestar të saj nuk ekziston ndonjë e dhënë dokumentare. A. Meksi, duke u bazuar në tiparet arkitektonike të kishës dhe në analogji me monumente të tjera, e daton kishën e shën e Premtes në Çetë të Kavajës në fundin e shekullit XIII (A. Meksi, "Kishat e Shqipërisë së Mesme e të Veriut", Monumentet 1, 1984, fq. 105-107).

Piktura murale, e cila vesh gjithë interiorin e kishës, e realizuar nga faza të

hershme deri në faza të vona, ruan vlera të larta artistike, ndërsa ikonostasi me dru të gdhendur cekët dhe me ngjyrë ari dhe ngjyra të tjera, dhe në tërësi me një pamje që krijon harmoni me pjesën tjetër të interierit, përmbante ikona të mjeshtrit të njohur të shekullit XVIII, Konstandin Shpatarakut.

Restaurimi

Duke konsideruar në mënyrë të veçantë vlerat e monumentit dhe gjendjen e tij, Kryepiskopi Anastas kërkoi nga Bërthama e Trashëgimisë Kulturore realizimin e një projekti restaurimi dhe shpëtimi. Këtë projekt e përshpejtoi dhe një zjarr i rënë në mënyrë të pashpjegueshme, i cili më shumë se të tjerat dëmtoi çatinë dhe afreskun në pjesën veri perëndimore të kishës.

Këto ndërhyrje konsistuan kryesisht në ndërhyrje lokale, tashmë të njohura dhe të zbatuara gjerësisht në praktikën restauruese, siç janë qepjet, injektimet, fugatimet dhe rindërtimet e pjesëve të degraduara, rikonstruksioni i çatisë etj..

Me këtë ndërhyrje të plotë restauruese ky monument u shpëtua nga degradimi dhe i shtohet listës së gjatë të monumente të restauruara nga Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë.

- KISHA TË RESTAURUARA -RESTAURIMI I KISHËS SË SHËN E PREMTES NË FSHATIN ÇETË, KAVAJËProjekti u hartua dhe u...

Geplaatst door [Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë](#) op [Woensdag 21 augustus 2019](#)

[Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë/facebook](#)